



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:139894

Datë: 03.07.2023

Numri i dokumentit: 04447087

Pml.nr.157/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare, Agim Maliqi dhe Afrim Shala, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të pandehurit I.T., për shkak të veprës penale nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik nga neni 147 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të *pandehurit* kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special PS.nr.59/2021 të datës 19.10.2022 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special APS.nr.2/2023 të datës 20.02.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 29 maj 2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit I.T., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special PS.nr. 59/2021 të datës 19.10.2022 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special APS.nr.2/2023 të datës 20.02.2023 dhe bazuar në nenin 363 par.1 nënpar.1.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), i pandehuri,

Lirohet nga akuza

Sepse në periudhën kohore deri sa ishte në pozitën e ministrit të Ministrinë e Administratës dhe Pushtetit Lokal në Qeverinë e Republikës së Kosovës, me dashje ka nxitur dhe përhapur publikisht urrejtje, përçarje dhe mosdurim midis grupeve kombëtare, racore dhe etnike që jetojnë në Republikën në Kosovës, ashtu që me datë 24.03.2019, në rrugën “Kral Millutini” në Zveçan, në cilësi të pjesëmarrësit dhe të folësit, në tubimin kundër intervenimeve të NATO-s në vitin 1999 në Kosovë të ashtuquajtur “në kujtim të viktimave të bombardimeve të NATO-së, shprehët se “arsyeja për agresionin në shtetin tonë ka qenë e ashtuquajtura katastrofë humanitare, Reçaku u shpik në Kosovë e Metohi dhe ishin ata terroristët shqiptar që shpikën të gjitha këto, kryen krimet më të mëdha në Kosovë dhe Metohi për të cilat askush deri më sot nuk ka marrë përgjegjësi. Kanë kryer krime para agresionit të NATO-s, kanë vrarë shtëpiak të mirë serb dhe polic në vendin e tyre të punës, vazhduan festën e përgjakshme gjatë agresionit dhe pas ardhjes së të ashtuquajturit mision paqësor në Kosovë e Metohi”, veprime këto të cilat mund ta prishin rendin publik në Republikën e Kosovës,

- me çka kishte për të kryer veprën penale nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik nga neni 147 par.1 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, me aktgjykimin PS.nr. 59/2021 të datës 19.10.2022, të pandehurin I.T. e ka shpallur fajtor për veprën penale nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik nga neni 147 par.1 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti. I pandehuri është obliguar në pagesën e paushallit gjyqësor në shumë prej 100 (njëqind) € dhe shumë prej 50 € në fondin për kompensimin e viktimave të krimit.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti Special, me aktgjykimin APS.nr.2/2023 të datës 20.02.2023, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe mbrojtësit të të pandehurit dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të pandehurit I.T., avokati Nebojsa Vlaciç nga Mitrovica, për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale ku shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ndryshojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe të pandehurin ta lirojë nga akuza, meqë veprimet e tij nuk përbëjnë vepër penale apo të pandehurit ti shqiptoj dënim me kusht.

Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.98/2023 e datës 25.04.2023, ka propozuar që kërkesa e mbrojtësit të të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e mbrojtësit të dënuarit të paraqitura në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë

Në kërkesë mbrojtësi i të pandehurit pretendon se gjykata e shkallës së parë dhe e shkallës së dytë nuk ishin kompetente në pikëpamje territoriale dhe se përbërja e kolegjeve penale ishte jo e duhur, për më tepër, theksohet fakti se kjo paraqet shkelje edhe të Marrëveshjes së Brukselit përkitazi me kompetencën territoriale dhe përbërjen e kolegjeve penale.

Në vijim të kërkesës janë paraqitur pretendime se në këtë çështje penale është shkelur edhe neni 10 i KEDLNj e cila është e zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë sipas nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës. Liria e shprehjes e përcaktuar me nenin 10 të Konventës, pretendohet se paraqet shtyllat kryesore mbi të cilat mbështetet funksionimi i demokracisë dhe ky nen nuk zbatohet vetëm për informacionet ose idetë të cilat pranohen nga publiku për miratim ose që konsiderohen të dëshirueshme dhe neutral, por zbatohen edhe për ato raste që mund të trondisin, shqetësojnë ose dëmtojnë shtetin ose ndonjë pjesë të popullatës e në veçanti për deklaratat e një natyre politike dhe me rëndësi për publikun, pra me këtë nuk mbrohet vetëm liria e shprehjes por përcakton të drejtën për një mendim si e drejtë absolute. Kurse kufizimet e përcaktuara me nenin 10 paragrafin 2 të KEDLNj, vjen në shprehje në rastet kur kemi mbrojtje të drejtës dhe interesit

ku cenohet siguria kombëtare, me ç'rast janë paraqitur raste edhe nga GJEDLNj duke u theksuar posaçërisht rastet e mohimit të holokaustit, por se rasti penal në këtë çështje konsiderohet se është larg këtij shembulli. Por theksohet fakti se GJEDLNj në zbatim të nenit 17 të KEDLNj, ka bërë ndarje të deklaratave që kuptohen si thirrje për hakmarrje ose kur personat mund të identifikohen me emër dhe urrejtja drejtohet kundër tyre. Dhe në këto raste personat e tillë i ekspozohen ndaj një rreziku të mundshëm dhe konkret të dhunës fizike, dhe në këto raste deklaratimet e bëra për dhunë nuk ishin në përputhje me drejtësinë dhe paqen, por për dallim nga kjo deklaratimet e të pandehurit nuk përmbajnë asnjë thirrje për hakmarrje, as dhunë ndaj askujt, as konkrete dhe as abstrakte, por deklaratimet e tij i referohen një ngjarje nga e kaluara dhe nuk ka të bëj me veprime që duhet të ndërmerren ndaj askujt dhe atë 20 vjet më vonë.

Pretendohet se praktika e GJEDLNj se arsyet e kur justifikohet qëllimi legjitim arsyetohet në rastet kur janë cenuar interesat e sigurisë kombëtare, integriteti territorial, ose siguria publik, parandalimi i trazirave ose krimi, mbrojtja e shëndetit ose morali, mbrojtja e reputacionit ose e të drejtave të të tjerëve, zbulimi i njoftimeve të marrë në konfidencë, por se asnjë arsye nuk ekziston në rastin konkret. Kurse në përputhje me këtë praktikë kufizimi i lirisë së shprehjes duhet të jetë me qëllim të ruajtjes së rendit publik, e që kjo do të nënkuptonte se deklarimi i të pandehurit duhet të rezultonte në prishjen e rendit publike formë të trazirave publike dhe se autoritetet duhet ti mbronin qytetarët nga dhuna e ndodhur. Prandaj ky kufizim pretendohet se nuk ishte as ligjor, as i nevojshëm dhe as në përputhje me praktikën e GJEDNj në disa raste, siç janë Stomakin & Rusisë dhe Perinçek & Zvicrës, përkatësisht duhet të tregohet se përmes deklaratimit të të pandehurit është arritur shkalla e qartë dhe e menjëhershme e rrezikut dhe se çfarë veprimi i paligjshëm mund të nxitet ose provokohet nga një fjalim i mbajtur para 10-15 pensionistëve dhe për të cilën ngjarje publiku ka mësuar rreth tri javë pas mbajtjes së saj.

Në kërkesë, tutje janë theksuar pretendime përkitazi me shkeljen e ligjit penal duke theksuar faktin se veprimet e të pandehurit nuk përbëjnë vepër penale nga neni 363 par.1.1 të KPP-së, përkatësisht nuk është për tu besuar se akti inkriminues kishte rrezikuar rendin publik, siç është përkufizuar me nenin 147 par.1 të KPRK-së. Meqë kjo nuk kishte gjasa dhe as që kishte ndodhur ndonjëherë, me përjashtim të zyrtarëve politik në Kosovë që dënuan deklaratën kur mësuan për të askush nuk ishte emocionuar për deklaratën e veçanërisht publiku dhe as rendi publik nuk ishte kërcënuar, për më tepër, askush nuk u rrezikua e asnjë qytetar i Kosovës nuk doli në rrugë dhe nuk protestoi. Gjykata e shkallës së parë nuk arsyetoi me asnjë fjalë të vetme pse konsideroi se këto shprehje të përdorura nga i pandehuri mund të kishin prishur rendin juridik kur nuk kishte ndodhur ndonjë shqetësim. Pra ajo që tha i pandehuri nuk paraqet krim dhe as që mund të kryhet

në këtë mënyrë meqë aktgjykimet e dy instancave më të ulëta e kthyen deliktin verbal në Kosovë, si krim që kërcënon lirinë e mendimit dhe shprehjes në një regjim jodemokratik dhe autoritar dhe asnjë shoqëri nuk duhet ti kufizoj këto liri edhe nëse shumica e popullatës nuk pajtohet me një mendim të tillë, pra gjithkush ka të drejtë që të thotë atë që e mendon përveç që të bëj thirrje për dhunë ndaj tjetrit ose ta provokojë atë.

Në kërkesë janë paraqitur pretendime për vendimin për dënim dhe janë bërë disa krahasime mes rastit në fjalë dhe rastit të GJEDNj Smajiq & Bosnjes dhe Hercegovinës, por të njëjtat pretendime për shkak të natyrës së vendimit të marrë nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë përshkruar tutje.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-së) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

Edhe pse mbrojtësi në kërkesë pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk janë vërejtur shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, por se bazuar në provat e administruara në këtë çështje penale del se aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë në shkelje të ligjit penal nga neni 385 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së, pasi që vepra për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor dhe është dënuar nuk është vepër penale. Pra, provat e administruara nga ana e dy gjykatave më të ulëta gjyqësore janë interpretuar në mënyrë të gabueshme dhe rrjedhimisht janë nxjerr konkludime të gabuara, dhe atë në dëm të të pandehurit, andaj, kjo e bën të mundur ndryshimin e aktgjykimeve duke e vendosur këtë çështje në mënyrë meritore.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se meqë në shqyrtimet e kaluara gjyqësore të të dy instancave më të ulëta gjyqësore, janë marrë në konsideratë të gjitha provat e mundshme për vendosjen e kësaj çështje penale, kjo gjykatë duhet t'i jap epilog kësaj çështje penale, për këto arsye: kjo çështje penale ka filluar prej datës 23.05.2019 (aktvendimi për fillim të hetimit), përkatësisht datës 28.06.2019 (kur është paraqitur aktakuza), dhe janë marrë dy aktgjykime nga gjykata e shkallës së parë dhe po aq nga ana e gjykatës së shkallës së dytë dhe gjithashtu edhe

një aktgjykim i Gjykatës Supreme të Kosovës, që del se në këtë çështje penale janë marrë pesë aktgjykime, dhe nga kjo del se janë tejkaluar standardet kohore të përcaktuar me KPP-në, me nenin 6/1 të KEDNJ, por edhe afati i arsyeshëm kohor për përfundimin e një procesi gjyqësor i aplikuar nga ana e GJEDNJ, të konstatuara në rastet: Cesarini kundër Italisë, Ollson kundër Suedisë, Kaçiu dhe Kotorri kundër Shqipërisë, Marini kundër Shqipërisë, Huseinoviç kundër Sllovenisë dhe Hokanen kundër Finlandës.

Gjykata e shkallës së parë të pandehurin e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik nga neni 147 par.1 të KPRK-së, duke përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit të saj se përmes fjalimit të tij, me dashje kishte nxitur dhe përhapur publikisht urrejtje, përçarje dhe mosdurim midis grupeve kombëtare, racore dhe etnike që jetojnë në Republikën në Kosovës, dhe për më tepër përmes këtij fjalimi, përkatësisht veprimi të tij këto mund ta prishin rendin publik në Republikën e Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës në tërësi pajtohet me konkludimet e nxjerra nga dy instancat gjyqësore se në rastin konkret sipas asaj që ceket në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë nuk rezultojnë të jenë kontestuese rrethanat se:

- i pandehuri me datën 24.03.2019, në rrugën “Kral Millutini” në Zveçan kishte qenë pjesëmarrës në tubimin e organizuar me rastin e ndërhyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë;
- aty kishte mbajtur fjalim para një numri personave të tubuar;
- përmbajtja e fjalimit të tij ishte në përputhje të plotë me përshkrimin e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Mirëpo nga këto rrethana, ashtu siç është pretenduar edhe në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, del se kontestuese është fakti se përmes këtij fjalimi a ishin përmbushur elementet e veprës penale në fjalë dhe se shprehjet e përdorura a paraqesin bazë për inkriminim apo fjalimi i të pandehurit nuk hyn në zonën penale dhe rrjedhimisht bën pjesë në të drejtën e garantuar për lirinë e shprehjes e përcaktuar me nenin 10 të KEDNJ dhe se ishin pikërisht këto dy aspekte që kanë bërë dallimin mes interpretimit të bërë nga gjykata e shkallës së parë dhe të cilin konstatim e kishte pranuar edhe gjykata e shkallës së dytë në njërën anë dhe Gjykatës Supreme të Kosovës në anën tjetër.

Fillimisht në këtë çështje penale është e nevojshme analiza e dispozitës së nenit 147 par.1 të KPRK-së e cila ka përcaktuar se: “Kushdo që nxit ose përhap publikisht urrejtje, përçarje ose mosdurim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike apo grupe të tjera të tilla që jetojnë në Republikën në Kosovës, në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik...”

Nga leximi i kësaj dispozite dhe përshkrimi i dispozitivit të aktgjyqimit të gjykatës së shkallës së parë vërehet një paqartësi e interpretimit të kësaj dispozite pasi që dispozita ligjore është e formuluar duke përcaktuar veprimin në formë alternative të kryerjes së veprës penale, kurse në dispozitiv të aktgjyqimit të gjykatës së shkallës së parë janë përshkruar të gjitha veprimet e përcaktuara në dispozitën ligjore, pra:

- nuk është përcaktuar saktësisht se cila formë e veprimit, *actus reus* ka ndodhur në rastin konkret, pra a bëhet fjalë për nxitje ose përhapje publike të urrejtjes, përçarjes ose mos durimit;

- paqartësia tjetër vërehet me faktin se gjithashtu nuk është përcaktuar *mens rea*, përkatësisht qëllimi i veprimit se ndërmarrja e veprimit a ka pasur qëllim nxitjen ose përhapjen publike të urrejtjes, përçarjes ose mos durimit mes grupeve kombëtare, racore apo etnike, pra nuk ka pasur qartësim në përshkrimin e dispozitivit të aktgjyqimit të gjykatës së shkallës së parë;

- dhe së fundmi nuk është argumentuar mundësia e prishjes së rendit publik si pasojë e këtyre veprimeve.

Përkundër kësaj, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore elementet e kësaj vepre penale do të duhej interpretuar në tërësinë e saj, përkatësisht në të gjitha elementet e saj dhe të cilat duhet të përmbushen në mënyrë kumulative dhe jo në mënyrë fragmentare. Andaj, fillimisht është e rëndësishme të përcaktohen elementet e kësaj vepre penale dhe më pas të konstatohet se a janë përmbushur apo jo elementet e kërkuara dhe atë: së pari duhet të përcaktohet fakti se fjalimi i të pandehurit a është bërë me qëllim të nxitjes ose përhapjes publike të urrejtjes, përçarjes ose mos durimit e që nga përmbajtja e fjalimit të tij del se i pandehuri gjatë fjalimit të tij ka përdorur opinione personale dhe të cilat as nuk janë faktuar, dhe ky element i veprës penale domosdoshmërisht duhet të ndërlidhet me qëllimin e të pandehurit që nxitja ose përhapja publike e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit mes grupeve kombëtare, racore apo etnike të bëhet me qëllim që fjalimi të ketë ndikim dhe të reflektoj që mes të mes grupeve kombëtare, racore apo etnike, pra në këtë rast mes grupeve kombëtare. Kurse përfundimisht këto të duhej të rezultojnë me mundësinë e prishjes së rendit publik.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës elementet e kërkuara sipas dispozitës ligjore të nenit 147 par.1 të KPRK-së në rastin konkret nuk janë përmbushur në mënyrë kumulative pasi që për të realizuar vepra penale. Së pari nxitja ose përhapja publike e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit nuk kishte ndodhur, meqë i pandehuri kishte shprehur një opinion të tij personal për ngjarje se vitit 1999 e që padyshim se opinioni i tij i shprehur me këtë rast edhe mund të mos përkon me opinionin e shumicës së banorëve të tjerë, por e rëndësishme në këtë aspekt është fakti se në këtë fjalim a u përdorën fjalët të cilat do të nxitnin një komunitet kundër komunitetit tjetër e që kjo në rastin konkret nuk ka ndodhur. Pra nga fjalimi i të pandehurit del se vetëm u konstatuan disa opinione të cilat nuk janë të sakta, por njëkohësisht në fjalim nuk pati përmbajtje të tillë që thërret në nxitje, urrejtje, përçarje apo mosdurim ndaj komunitetit tjetër. Për më tepër, opinioni i paraqitur nga ana e të pandehurit lidhur me ngjarjen për të cilën ishte organizuar tubimi nuk u përcjell me ndonjë manifestim të hapur të urrejtjes ndaj një kombi tjetër në këtë rast kombit shqiptar.

Në këtë kontekst pa dyshim se nuk është realizuar as mundësia e prishjes së rendit publik, pa dyshim se gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore në arsyetimet e aktgjykimeve të tyre në mënyrë të drejtë kanë interpretuar dispozitën ligjore se për kryerjen e kësaj vepre penale nuk është e domosdoshme prishja e rendit publik, por mjafton të argumentohet fakti i rrezikut abstrakt. Por sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, tani më kjo mundësi e prishjes së rendit publik ishte tejkaluar nga një rrezik abstrakt në atë konkret, meqë edhe një kohë të gjatë pas ngjarjes nuk kishin ndodhur reagime të atij dimensionit që do të manifestonte prishjen e rendit publik për shkak të deklarimeve të të pandehurit. Për më tepër, siç është përkufizuar GJEDNj në vendimin e saj: „...se gjykatat vendase duhet të kishin shpjeguar se si mund të konsiderohet konkretisht sjellja e kërkuesit si nxitje e dhunë, rezistencës së armatosur ose kryengritjes, apo si përbën ajo gjuhë urrejtje...” - rasti Mart e të tjerë & Turqisë nr.87031/10, &32, për të vazhduar me vendimin tjetër se: „...drejtësia procedurës dhe garancitë procedurale që i ofrohen kërkuesit janë faktorë që duhet të merren parasysh gjatë vlerësimit të proporcionalitetit të ndërhyrjes në lirinë e shprehjes...”- rasti Baka & Hungarisë nr.20261/12, &161. Pra të dy këto aspekte nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtë nga ana e dy gjykatave të instancave më të ulëta gjyqësore, pra nuk është theksuar se si ishte manifestuar gjuha e urrejtjes dhe njëkohësisht ishte anashkaluar në tërësi aspekti i proporcionalitetit të veprimit të të pandehurit.

Edhe pse qëndron fakti se i pandehuri në fjalimin e tij përdori qartazi fjalor të papërshtatshëm dhe i cili nuk reflekton me opinionin e një pjesë të madhe të popullatës vendore, megjithatë në këtë

rast para Gjykatës Supreme të Kosovës u paraqit si çështje e rëndësishme përcaktimi i përkufizimit se deri ku shtrihet kufiri mes të shprehjes së lirë të opinionit (në këtë rast nga ana e të pandehurit) dhe inkriminimi ligjor i veprës penale dhe i cili aspekt del se nga dy instancat më të ulëta gjyqësore nuk është qartësuar dhe analizuar sa duhet. Për më tepër, përkufizim del të jetë i varfër edhe sa i përket praktikës gjyqësore vendore, andaj me këtë rast ishte i domosdoshëm referimi në disa vendime të GJEDNJ, me qëllim të përcaktimit të lirisë së shprehjes e përcaktuar me nenin 10 të KEDLNJ dhe inkriminimit ligjor.

Fillimisht duhet theksuar faktin se KEDLNJ, ka zbatim të drejtpërdrejt në vendin tonë duke u bazuar në nenet 22 dhe 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe kanë prioritet në rast konfliktit me dispozitat ligjore vendore dhe gjykatat vendore janë të obliguara që rastet e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore t'i interpretojnë në harmoni me vendimet gjyqësore të GJEDNJ, andaj duke pasur fokusin në këtë është e nevojshme së pari të përcaktohet se në fjalimin e të pandehurit a u paraqitën opinione apo fakte.

Pra, duke u referuar në fjalimin e të pandehurit del se i njëjti shfaq një opinion të tij, meqë fjalitë e përdorura se: *“arsyeja për agresionin në shtetin tonë ka qenë e ashtuquajtura katastrofë humanitare, Reçaku u shpik në Kosovë e Metohi dhe ishin ata terroristët shqiptar që shpikën të gjitha këto, kryen krimet më të mëdha në Kosovë dhe Metohi për të cilat askush deri më sot nuk ka marrë përgjegjësi. Kanë kryer krime para agresionit të NATO-s, kanë vrarë shtëpiak të mirë serb dhe polic në vendin e tyre të punës, vazhduan festën e përgjakshme gjatë agresionit dhe pas ardhjes së të ashtuquajturit mision paqësor në Kosovë e Metohi”*, nuk paraqesin ndonjë fakt rreth të thënjeve të tij. Për më tepër, siç është përkufizuar GJEDNJ në vendimin e saj, *“...ekzistimi i fakteve mund të demonstrohet, ndërsa opinionet nuk mund t'i nënshtrohen vërtetësisë...”* rasti Lingens & Austrisë nr.29815/82, për të vazhduar se e drejta e opinionit është aspekt thelbësor i së drejtës së lirisë së shprehjes dhe garantohet me nenin 10 të KEDLNJ. Prandaj, obligimi që opinionet t'i nënshtrohen vërtetësisë do të cenonte drejtpërsëdrejti mbrojtjen e garantuar me Konventë, përkatësisht se opinionet janë pikëpamje ose vlerësime personale të një ngjarje ose një situatë dhe nuk mund të konstatohen nëse janë të vërteta ose të pavërteta. Kurse qëndrim të ngjashëm GJEDNJ ka përkufizuar edhe në vendimin e saj në rastin Dalban & Rumanisë nr.28114/95 me ç'rast ka njohur konceptin e mirëbesimit si mbrojtje *“...edhe në rastet kur jo të gjitha faktet janë të sakta dhe se përshkrimi i ngjarjeve të pasqyruara në shkrime ishte tërësisht i pavërtetë...”*.

Gjykata Supreme e Kosovës nuk pajtohet me konkludimet e nxjerra nga ana e gjykatës së shkallë së parë, meqë në fjalimin e të pandehurit nuk ishte paraqitur ndonjë fakt, por ishin shfaqur opinione të cilat nuk është e nevojshme që të faktohen se a janë të vërteta apo jo, dhe për më tepër, përkundër faktit se: “...opinionit i të pandehurit shpreh një opinion që dallonte nga opinionet e vendosura...”- Perinçek & Zvicrës, nr. 27510/08, 15 tetor 2015.

Në përmbyllje të këtij aktgjykimi, Gjykata Supreme e Kosovës shpreh shqetësimin e saj përkitazi me standardin e aplikuar së pari nga ana e Prokurorisë së Shtetit e mbështetur pastaj nga ana e dy gjykatave të dy instancave më të ulëta gjyqësore, të cilat përdorën një standard minimal dhe që veprimet e të pandehurit i cilësuan si veprime që përbëjnë vepër penale dhe atë pa një vlerësim dhe analizë të mirëfilltë dhe gjithëpërfshirëse të provave që ishin në shkresat e lëndës dhe njëkohësisht duke bërë interpretim të gabuar të ligjit penal. Me këto veprime del se janë shkelur rregullat bazike të prezumimit të pafajësisë të garantuara *përmes mekanizmave të brendshëm* neni 31 par.5 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 3 i KPP-së, meqë gjykata me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të të pandehurit, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me *parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo*, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij, kurse në ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë “*in peius*” ndaj të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshem dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet që janë “*in favorem*” ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet, *si dhe përmes mekanizmave të jashtëm* KEDLNj dhe GJEDLNj e së ndërtuar përmes vendimeve të saja: Minelli & Zvicrës, Murray & Britanisë së Madhe, Tefler & Austrisë, Lavents & Letonisë, etj., në të cilat vendime rëndësi vendimtare i kushtohet parimit të prezumimit të pafajësisë, përkatësisht kërkesës që kryerja e detyrave nga ana e anëtarëve të një gjykate nuk duhet të filloj me idenë e paracaktuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, barra e provës i takon prokurorit dhe çdo dyshim duhet të jetë në favor të akuzuarit.

Nga të gjitha këto, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje të ligjit penal dhe të cilat shkelje nuk janë mënjeluar nga ana e gjykatës së shkallës së dytë e cila vendosi sipas mjetit të rregullt juridik dhe njëkohësisht pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit i paraqitur në kërkesë ishte i bazuar, andaj për

këtë arsye u vendos që konform nenit 438 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së, aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.157/2023, më 29 maj 2023

B.profesional,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka